



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 6810 Prot

Tiranë, më 23.12 2020

UDHËZIM

Nr. 27 datë 23.12 2020

PËR

**NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020 "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre",

**U D H Ë Z O J:**

1. Pas pikës 5/3 të Kreut VI të udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, të ndryshuar, shtohet pika 5/4 me përmbajtjen si më poshtë:

*"5/4. Përgjithësisht, aplikimet për programet e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" për vitin akademik 2021–2022, do të pranohen deri në 31 Mars të vitit 2021.*

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI

Evis KUSHI

